



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2012 Prot

Vlorë, më 29.09.2025

VENDIM

Nr. 18, datë 25.09.2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË
BASHKISË SELENICË 2025 – 2030

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.09.2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, pikës 5, 7 të nenit 13, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Selenicë Nr. 46, datë 27.08.2025 (Nr. 2061 Prot, datë 02.09.2025) “Për miratimin e Planit Vendor të Integruar të Mbetjeve i Bashkisë Selenicë 2025 – 2030”,

VENDOSI;

1. Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Selenicë 2025 – 2030.
2. Bashkëlidhur Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Selenicë 2025 – 2030.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social në institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në mbështetje të pikës 3, nenit 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën Nr. _____ Prot, datë _____.2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë është protokolluar me tonën Nr. 1787 Prot, datë 03.09.2025, shkresa e Bashkisë Selenicë Nr. 2061/1 Prot, datë 03.09.2025, me lëndë "Përcjellje Vendimi të Këshillit të Bashkisë Selenicë", bashkëlidhur së cilës gjendet Vendimi i Këshillit Bashkiak Selenicë Nr. 46, datë 27.08.2025 (Nr. 2061 Prot, datë 02.09.2025) "Për miratimin e Planit Vendor të Integruar të Mbetjeve i Bashkisë Selenicë 2025 – 2030".

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, Bashkia Selenicë duke patur në vëmendje mbajtjen pastër të mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, promovimin e ekonomisë qarkulluese si dhe mbështetjen e zhvillimit rural të qëndrueshëm ka hartuar, nëpërmjet drejtimit metodologjik të programit Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta, Rajoni Vlorë, në kuadër të asistencës së qeverisë Gjermane, zbatuar nga INFRASTRUKTUR & UMWELT, RWA dhe FLAG, Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Selenicë 2025 – 2030.

Nëpërmjet Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Selenicë 2025 – 2030, bashkia synon reduktimin në përgjithësi të mbetjeve dhe atyre organikeve në veçanti, ndërgjegjësimin e banorëve për një mjedis sa më të pastër i cili do të ndikojë në cilësinë e jetesës.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Selenicë Nr. 46, datë 27.08.2025 (Nr. 2061 Prot, datë 02.09.2025) "Për miratimin e Planit Vendor të Integruar të Mbetjeve i Bashkisë Selenicë 2025 – 2030", është vlerësuar i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresë Nr. 851/1 Prot, datë 10.09.2025.

Mëshketur në pikën 7, nenit 13 "Procedurat për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve", të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndryshuar, Plani Vendor i Menaxhimit të mbetjeve hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli i Qarkut, ndaj Ju ftojme që të procedojmë me miratimin e këtij projektvendimi.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Drejtore të Drejtorisë së Finacës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Anisa Hyseni

Jurist

Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600